

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date **24 Prill 2024** (dymije e njezet e kater) nenshkruhet kjo kontrate mes paleve:

Z.Paul Hila, shtetas shqiptar, lindur me 08.11.1992 ne Shkoder, dhe banuese ne Tirane me nr personal **J21108046R**, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

(ne vijim referuar si "Shitesit")

dhe

Z. Neli Begaj, shtetas shqiptar, lindur me 25.08.1998 ne Fier e banues ne Tirane, me nr personal **J80825104U**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar

(ne vijim referuar si "Bleresi")

Ne vijin e per efekt te kesaj Kontrate, Shitesit dhe Bleresi do te referohen vecmas si Pale/a dhe se bashku si

Pale/t. MEQENESE:

A. Shoqeria "**BN Service**" Sh.P.K., eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi **M41623026G**, me kapital themeltar **1.000.000 Leke**, te zoteruara ne masen **100%** nga Ortaku **Paul Hila**.

(me poshte referuar "Shoqeria").

B. Shitesi deshiron ti transferoj kuotat te kapitalit te zoteruar prej tij ne Shoqeri dhe Bleresi ka pranuar ti bleje kuotat e zoteruara dhe te ofruar nga Shitesi ne Shoqeri;

C. Ne zbatim te kerkesave te Statutit te Shoqerise, Palet kane vendosur te lidhin kete Kontrate;

ATEHERE, duke qene se ekzistojne keto kushte paraprake, per te cilat Palet nuk kane pretendime apo kundershime. Palet bien dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1 Objekti

1.1 Nepermjet kesaj Kontrate :

-Shitesi **Paul Hila** i shet Bleresit 1 kuote e barabarte me 100% te kapitalit te zoteruar prej tij

dhe bleresi **Neli Begaj** blen nga :

-Shitesi **Paul Hila** i shet Bleresit 1 kuote e barabarte me 100% te kapitalit te zoteruar prej tij ne vleren 1.000.000 Leke

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i siperpërmendur i shitjes është paguar teresisht nga blerësi tek shitësi para nënshkrimit të kontratës, dhe palët konfirmojnë se nuk kanë pretendime në lidhje me çmimin e shitjes dhe mënyrën e pagesës.

Neni 3 Deklarimet dhe garanci

3.1 Shitësi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuota të do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për të transferuar këto kuota dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Shitësi.

3.2. Blerësi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Blerësi ka tagra të plotë për të pranuar kuota nga Shitësi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Blerësi.

Neni 4 Transferimi i të drejtave mbi kuota

4.1. Pronesia mbi kuota të Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi të Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe që nga ky moment Blerësit i lind e drejta e regjistrimit të kësaj kontrate në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe Shitësi bie dakort për këtë.

4.2. Menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate Blerësi behet ortak i Shoqërisë duke zotëruar 1 kuota të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 1.000.000 Leke.

4.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuota të zotëruara në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi dhe për ndjekjen e kësaj procedure autorizon : Z. **Paul Hila**, me numer. Personal **J21108046R**.

Neni 5 Te ndryshme

5.1. Çdo kusht, klauzole apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmeria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cenohet nga pavlefshmeria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër,

5.2. Kjo Kontrate do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 990112008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.3. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontrate do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet


Paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

5.4. Kjo Kontrate hartohet ne gjuhen Shqipe ne 2 (dy) origjinale. Lexuar, pranuar e nenshkuar nga palet.

SHITESIT


BN SERVICE
Paul Hila
M416230266

BLERESI


Neli Begaj